



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 267 / prot.

Tiranë, më 23.2.2026

VENDIM

Nr. 5, datë 23.02.2026

"Për miratimin e Rregullores "Për parandalimin e plagjaturës në Universitetin e Tiranës"

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa "d" dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa "e", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.831 datë 30.12.2025 "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor"; Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019, "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë"; Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 23.02.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren " Për parandalimin e plagjaturës në Universitetin e Tiranës"
2. Vendimi i përcillet për njohje dhe zbatim, sipas kompetencave të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës dhe Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

PËR PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS DHE RESPEKTIMIN E ETIKËS NË
KËRKIMIN SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

TIRANË, 2026



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e një kuadri të unifikuar institucional për parandalimin, identifikimin, verifikimin dhe trajtimin e plagjiaturës, në të gjitha format e veprimtarisë akademike, mësimore dhe kërkimore-shkencore në Universitetin e Tiranës (UT).
2. Ajo synon garantimin e integritetit akademik dhe shkencor, respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, mbrojtjen dhe forcimin e reputacionit akademik të UT-së si institucioni kryesor i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri.
3. Dispozitat e kësaj rregulloreje bazohen në legjislacionin kombëtar në fuqi dhe janë të harmonizuara me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, duke theksuar parandalimin, edukimin, transparencën, të drejtën për proces të rregullt dhe aplikimin e masave disiplinore proporcionale.

Neni 2

Baza Ligjore

1. Kjo rregullore hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet institucionale të Universitetit të Tiranës, në veçanti bazuar në:
- a) Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton parimet themelore të autonomisë akademike, cilësisë, integritetit dhe etikës në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;
 - b) Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit, transparencës dhe të drejtës për proces të rregullt administrativ;
 - c) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar;
 - ç) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”;
 - d) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.831 datë 30.12.2025 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor”
 - dh) Udhëzimin e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019, “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”;
 - e) Statutin e Universitetit të Tiranës;
 - ë) Rregulloren e Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 20, datë 27.07.2022, dhe të ndryshuar me Vendimin nr. 17, datë 27.02.2023;



f) Kodin e Etikës së Universitetit të Tiranës, si dhe aktet që rregullojnë kompetencat dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.

2. Kjo rregullore është gjithashtu e harmonizuar me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e integritetit akademik dhe etikës në kërkim, veçanërisht me Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkim (ALLEA) dhe udhëzimet e rrjeteve evropiane për integritet akademik dhe shkencor.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë subjektet që marrin pjesë në veprimtari akademike dhe kërkimore-shkencore në Universitetin e Tiranës si më poshtë:

- a) studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve;
- b) personelin akademik dhe personelin kërkimor-shkencor të Universitetit të Tiranës;
- c) studiuesit kërkimorë-shkencorë dhe individët e tjerë që, në çfarëdo forme, marrin pjesë ose kontribuojnë në veprimtari akademike, kërkimore-shkencore, botime, projekte ose aktivitete shkencore të Universitetit të Tiranës.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **Plagjiatura** është çdo formë përvetësimi ose përdorimi i fjalëve, ideve, koncepteve, teorive, të dhënave, ilustrimeve, tabelave, figurave, çdo elementi tjetër të veprës intelektuale të një personi tjetër dhe veçanërisht rezultateve kërkimore, pa atribuirimin e duhur dhe të verifikueshëm të burimit origjinal, duke e paraqitur atë si vepër ose kontribut origjinal.

2. **Format e plagjiaturës** përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a) kopjimin e plotë ose të pjesshëm të tekstit, ideve, të dhënave ose rezultateve të një autori tjetër, pa cituar burimin nga është marrë;
- c) përdorimin e ideve, hipotezave, modeleve teorike, metodologjive, algoritmeve, të dhënave, kodeve burimore ose materialeve vizuale të një personi tjetër pa leje dhe pa atribuirim të qartë të autorësisë;
- ç) dorëzimin, paraqitjen ose publikimin e punës së një personi tjetër si punë personale, përfshirë blerjen, porositjen ose përvetësimin e punimeve akademike ose shkencore nga palë të treta;
- d) përkthimi i një teksti nga një gjuhë tjetër dhe paraqitja e tij si punë origjinale pa cituar burimin.

3. **Etika akademike dhe shkencore** është tërësia e parimeve, normave dhe standardeve të sjelljes që rregullojnë veprimtarinë mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore, duke përfshirë ndershmërinë intelektuale, përgjegjshmërinë, transparencën, respektimin e autorësisë, shmangien e konfliktit të interesit dhe mbrojtjen e integritetit akademik.



4. **Integriteti akademik dhe shkencor** nënkupton respektimin e parimeve të ndershmerisë, besueshmërisë, objektivitetit dhe përgjegjshmërisë në prodhimin, paraqitjen, publikimin dhe vlerësimin e punës akademike dhe kërkimore, përfshirë raportimin e saktë të burimeve, rezultateve dhe kontributeve individuale.
5. **Pronësia intelektuale** është e drejta morale dhe pasurore e autorit/bashkëautorit ose e mbajtësit ligjor mbi veprën intelektuale, përfshirë punimet akademike, kërkimet shkencore, botimet, të dhënat, softuerët, materialet mësimore dhe çdo krijim tjetër origjinal, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave institucionale të Universitetit të Tiranës.
6. **Mashtrimi akademik** është çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që synon të sigurojë përfitim të padrejtë akademik ose shkencor, përfshirë plagjiaturën, paraqitjen e të dhënave të rreme, manipulimin e rezultateve kërkimore, përdorimin e mjeteve të paautorizuara, ose ndërhyrjen në proceset e vlerësimit akademik.
7. **Autorësia** nënkupton kontributin intelektual thelbësor në konceptimin, realizimin, analizimin ose shkrimin e një pune akademike ose shkencore, ndërsa **bashkautorësia** nënkupton ndarjen e përgjegjësisë dhe meritës për veprën ndërmjet dy ose më shumë autorëve, në përputhje me kontributin real të secilit.
8. **Konflikti i interesit** është çdo situatë në të cilën interesat personale, profesionale, financiare ose institucionale të një subjekti mund të ndikojnë ose të perceptohen se ndikojnë në mënyrë të padrejtë në objektivitetin, paanshmërinë ose integritetin e veprimtarisë akademike, kërkimore ose vendimmarrëse.
9. **Mjetet antiplagjiaturë** janë programet dhe sistemet teknologjike të përdorura për analizimin e ngjashmërisë së tekstit dhe identifikimin e rasteve të mundshme të plagjiaturës, të cilat shërbejnë si mjet ndihmës dhe nuk zëvendësojnë vlerësimin akademik, etik dhe profesional të strukturave të verifikuese.
10. **Indeksi i ngjashmërisë** është treguesi sasior, i shprehur në përqindje, i gjeneruar nga sistemet antiplagjiaturë, i cili pasqyron vetëm nivelin e përputhjes tekstuale të fjalëve dhe/ose fjalive të një punimi me burime të tjera të identifikuara në bazat përkatëse të të dhënave. Ky tregues nuk përbën dhe nuk nënkupton automatikisht plagjiaturë, ka karakter ndihmës dhe orientues dhe interpretohet gjithmonë në mënyrë të kombinuar me analizën cilësore të përmbajtjes, duke marrë parasysh kontekstin shkencor dhe disiplinor, natyrën e burimeve, qëllimin akademik të punimit dhe kontributin origjinal të autorit.
11. **Marrja, porositja ose blerja si edhe përdorimi i punës së tjetrit**, të pabotuar, pa pëlqimin dhe pa atribuimin e duhur të autorit, dhe paraqitja e saj si punim origjinal, përbën shkelje të rëndë të etikës dhe profesionalizmit akademik dhe trajtohet njësoj me plagjiaturën, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara në këtë rregullore.
12. **Deklarata korrigjuese** është një deklaratë e shkruar e autorit, e cila shoqëron punimin akademik ose shkencor dhe nënvizon se përmbajtja e tij është korrigjuar ose rishikuar pas konstatimit të shkeljeve të etikës akademike ose mangësive metodologjike, me qëllim rivendosjen e korrektesisë, transparencës dhe integritetit akademik, pa cenuar vlefshmërinë formale të punimit.
13. **Shënim etik shpjegues** është një deklaratë institucionale e arsyetuar, e publikuar në arkivën institucionale të Universitetit të Tiranës dhe e bashkëlidhur me punimin akademik ose



shkencor përkatës, e cila, në bazë të një vendimi institucional, informon për ekzistencën dhe natyrën e një shkeljeje të konstatuar të etikës akademike ose të integritetit shkencor dhe, sipas rastit, nënvizon se publikimi është korrigjuar ose rishikuar pas konstatimit të shkeljes etike ose se ai nuk mund të përdoret apo të referohet për qëllime akademike për shkak të konstatimit të një shkeljeje të rëndë ose shumë të rëndë.

Neni 5

Raste që nuk përbëjnë plagjiaturë dhe vlerësimi i kontributit original

1. Nuk përbën plagjiaturë ripërdorimi i punimeve personale të autorit, vetëm në rastet kur këto punime:

a) janë hartuar në kuadër të studimeve doktrale dhe janë pjesë përbërëse e procesit kërkimor për fitimin e gradës shkencore;

b) nuk janë publikuar më parë si punime të pavarura shkencore ose akademike jashtë kuadrit të studimeve doktrale;

c) paraqiten ose publikohen si rezultate të drejtpërdrejta të kërkimit doktral, përfshirë artikuj, raporte, kapituj ose materiale të tjera që rrjedhin nga disertacioni;

ç) janë vepra me autor të vetëm, ku kontributi intelektual është individual, i identifikueshëm dhe i verifikueshëm.

Në këto raste, përfshirja e përmbajtjes së tillë në disertacion, publikime ose punime të tjera të lidhura me studimet doktrale nuk kërkon referencë të veçantë ndaj disertacionit, për sa kohë që ruhet transparenca akademike dhe koherenca e procesit kërkimor.

2. Nuk përbën plagjiaturë përdorimi ose citimi i burimeve parësore dhe materiale standarde, të cilat për nga natyra e tyre përdoren nga një numër i madh autorësh, përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) dokumente zyrtare, tekste normative, standarde teknike, protokolle, udhëzime, ose akte të tjera institucionale;

b) të dhëna parësore, sete të dhënash, materiale arkivore, burime eksperimentale, mostra, imazhe, sinjale ose rezultate të matjeve, për sa kohë që përdorimi i tyre bëhet në përputhje me rregullat e citimit dhe aksesit;

c) burimeve parësore që, për nga natyra e tyre, përdoren dhe interpretohen nga një numër i madh autorësh.

ç) vendime gjyqësore, përfshirë praktikën gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, legjislacion ndërkombëtar dhe kombëtar, akte nënligjore, traktate ndërkombëtare, akte administrative dhe burimeve të tjera primare normative ose institucionale;

d) fakte të njohura botërisht të cilat nuk kanë nevojë të referohen;

3. Nuk përbën plagjiaturë prania e ngjashmërive të kufizuara tekstuale, terminologjike, metodologjike ose strukturore, të identifikuar nga sistemet antiplagjiaturë, kur këto:



- a) janë të pashmangshme për shkak të natyrës së disiplinës, terminologjisë standarde, metodave të konsoliduara ose strukturave të zakonshme të raportimit shkencor;
- b) nuk cenojnë autorësinë, individualitetin dhe vlerën shkencore ose akademike të punimit;
- c) nuk ndikojnë në identifikimin e kontributit origjinal të autorit
- d) përmbajnë citime të paplota ose të gabuara të cilat në thelb nuk çenojnë autorësinë e një autori tjetër.

4. Kontributi origjinal nënkupton shtesën intelektuale individuale të autorit në formën e ideve, hipotezave, analizës, interpretimit, metodologjisë, dizajnit kërkimor, rezultateve empirike ose krijimeve akademike, e cila dallon qartësisht punimin nga burimet ekzistuese dhe përbën vlerë të re shkencore ose akademike në disiplinën përkatëse.

Neni 6

Parimet e parandalimit dhe edukimit kundër plagjiaturës

1. Universiteti i Tiranës zbaton një qasje parandaluese dhe edukative ndaj plagjiaturës, duke synuar krijimin dhe forcimin e një kulture të qëndrueshme të integritetit akademik dhe shkencor në të gjitha ciklet e studimit dhe fushat e kërkimit.
2. Parandalimi i plagjiaturës mbështetet në parimet e mëposhtme themelore:
 - a) **Parimi i edukimit të vazhdueshëm**, sipas të cilit studentët, personeli akademik dhe kërkimor-shkencor informohen dhe trajnohen rregullisht mbi standardet e etikës akademike, rregullat e citimit, autorësinë, përdorimin korrekt të burimeve dhe shmangien e plagjiaturës;
 - b) **Parimi i transparencës**, që garanton akses të qartë dhe të barabartë në rregullat, udhëzimet, procedurat dhe pasojat që lidhen me shkeljet e etikës akademike;
 - c) **Parimi i përgjegjësisë individuale**, sipas të cilit çdo subjekt akademik mban përgjegjësi personale për integritetin e punës së tij akademike ose shkencore;
 - ç) **Parimi i proporcionalitetit**, që kërkon që masat parandaluese dhe disiplinore të jenë të përshtatshme, të arsyetuara dhe proporcionale me natyrën, shkallën dhe rrethanat e shkeljes;
 - d) **Parimi i procesit të rregullt**, që garanton trajtim të drejtë, të paanshëm dhe transparent të çdo rasti të dyshuar për plagjiaturë, duke respektuar të drejtën për informim, mbrojtje dhe ankimim;
 - dh) **Parimi i vlerësimit akademik cilësor**, sipas të cilit identifikimi i plagjiaturës nuk bazohet vetëm në tregues sasiorë ose teknologjikë, por në analizë profesionale, akademike dhe disiplinore të përmbajtjes;
 - e) **Parimi i mbështetjes institucionale**, që parashikon ofrimin e udhëzimeve, burimeve dhe këshillimit akademik për studentët dhe stafin, me qëllim parandalimin e shkeljeve të paqëllimshme të etikës akademike.
3. Universiteti i Tiranës siguron që politikat e parandalimit dhe edukimit kundër plagjiaturës të integrohen në:
 - a) programet e studimit dhe kurrikulat mësimore;



- b) orientimin fillestar të studentëve dhe personelit të ri akademik;
 - c) veprimtaritë kërkimore-shkencore, projektet dhe publikimet;
 - ç) udhëzimet metodologjike për hartimin e punimeve akademike dhe shkencore.
4. Masat parandaluese dhe edukative zbatohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, duke marrë parasysh specifikat e disiplinave të ndryshme shkencore dhe niveleve të studimit.

KREU II

PARANDALIMI DHE EDUKIMI

Neni 7

Detyrimi i Edukimit për integritetin akademik

1. Universiteti i Tiranës siguron edukim të detyrueshëm për integritetin akademik dhe etikën në kërkim për të gjithë studentët e regjistruar për herë të parë, si dhe për personelin akademik dhe kërkimor-shkencor.
2. Edukimi për integritetin akademik realizohet përmes trajnimeve, moduleve orientuese, materialeve udhëzuese dhe aktiviteteve të tjera edukative, të përshtatura sipas ciklit të studimit dhe specifikave të disiplinës.
3. Trajnimet përfshijnë, në mënyrë të detyrueshme:
 - a) përkufizimin dhe format e plagjiaturës dhe mashtrimit akademik;
 - b) rregullat dhe teknikat e citimit dhe referencimit të duhur;
 - c) parimet e autorësisë, bashkautorësisë dhe kontributit origjinal;
 - ç) përdorimin korrekt të burimeve parësore dhe dytësore;
 - d) funksionimin dhe interpretimin e raporteve të sistemeve antiplagjiaturë;
 - dh) raste studimore dhe shembuj praktikë të shkeljeve dhe praktikave të mira akademike.
4. Pjesëmarrja në aktivitetet edukative për integritetin akademik është pjesë përbërëse e procesit mësimor dhe institucional dhe dokumentohet sipas procedurave të brendshme të UT-së.

Neni 8

Kontrolli antiplagjiaturë për punimet dhe botimet akademike

1. Punimet akademike dhe shkencore që dorëzohen, vlerësohen ose publikohen në kuadër të Universitetit të Tiranës duhet të kenë kryer kontrollin antiplagjiaturë përmes sistemeve të licencuara dhe të njohura për këtë qëllim, në përputhje me praktikën dhe standardet akademike në fuqi.
2. Detyrimi për kryerjen e kontrollit antiplagjiaturë zbatohet, në veçanti, për:
 - a) vlerësimin e punimeve të studentëve në ciklin e dytë dhe të tretë të studimit;



b) verifikimin e punimeve shkencore të personelit akademik dhe kërkimor-shkencor, para publikimit;

c) vlerësimin e artikujve shkencorë përpara publikimit në revista shkencore të Universitetit të Tiranës;

ç) vlerësimin e referimeve dhe kumtesave shkencore përpara publikimit në botimet (Proceedings) e konferencave shkencore të organizuara nga njësitë kryesore ose bazë të Universitetit të Tiranës.

3. Autorët ose strukturat përgjegjëse për vlerësimin apo publikimin janë të detyruar:

a) të sigurojnë që kontrolli antiplagjiaturë të jetë kryer;

b) të administrojnë raportin përkatës si pjesë të dokumentacionit akademik;

c) të njoftojnë njësinë bazë përkatëse për kryerjen e kontrollit.

4. Kontrolli antiplagjiaturë i kryer në këtë fazë ka karakter parandalues dhe edukativ dhe nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e plagjiaturës.

Neni 9

Informimi dhe transparenca

1. Kjo rregullore, së bashku me udhëzimet, materialet ndihmëse dhe informacionin për procedurat e parandalimit dhe trajtimit të plagjiaturës, publikohet dhe mbahet e përditësuar në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës.

2. Universiteti i Tiranës siguron transparençë institucionale lidhur me politikat, procedurat dhe përgjegjësitë në fushën e integritetit akademik, duke nxitur ndërgjegjësimin dhe parandalimin e shkeljeve.

KREU III

INSTRUMENTET E VERIFIKIMIT DHE KLASIFIKIMI I SHKELJEVE

Neni 10

Përdorimi i raporteve antiplagjiaturë në rast dyshimi ose kërkese për konstatimin e plagjiaturës

1. Raportet antiplagjiaturë përdoren si dokumentacion verifikues vetëm në rast se paraqitet kërkesë nga një subjekt i legjitimuar sipas kësaj rregulloreje që pretendon konstatimin e plagjiaturës në kërkimin shkencor brenda UT



2. Në këto raste, raportet antiplagjiaturë administrohen nga strukturat akademike kompetente dhe përbëjnë mjet ndihmës për shqyrtimin akademik, etik dhe disiplinor, pa zëvendësuar vlerësimin profesional të organeve përkatëse.
3. Asnjë vendim akademik ose disiplinor nuk mund të merret vetëm mbi bazën e përqindjes së ngjashmërisë të pasqyruar në raportin antiplagjiaturë.
4. Raportet antiplagjiaturë mund të administrohen si prova vetëm në kuadër të procedurave të parashikuara nga kjo rregullore dhe nuk mund të përdoren për qëllime jashtë procesit akademik ose disiplinor.

Neni 11

Shkallët dhe nivelet e plagjiaturës

1. Vlerësimi i plagjiaturës në veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës bëhet në përfundim të një analize të kombinuar sasiore dhe cilësore, e cila merr parasysh njëkohësisht:
 - a) përqindjen e ngjashmërisë së identifikuar nga sistemet antiplagjiaturë të miratuara;
 - b) natyrën e përmbajtjes së përputhur;
 - c) kontekstin shkencor dhe të disiplinës;
 - ç) qëllimshmërinë ose pakujdesinë e autorit;
 - d) dhe veçanërisht kontributin origjinal të punimit dhe rëndësinë e tij në kuadër të kërkimit shkencor.
2. Përqindja e ngjashmërisë ka karakter orientues dhe nuk përbën, në vetvete, provë automatike të plagjiaturës. Klasifikimi përfundimtar i nivelit të shkeljes bëhet mbi bazën e vlerësimit akademik dhe etik.
3. Në përfundim të vlerësimit sasior dhe cilësor, shkeljet klasifikohen në këto nivele:
 - a) **0–15%** – nuk përbën shkelje
 - b) **mbi 15% deri në 30%** – shkelje e lehtë e etikës në kërkimin shkencor, e cila nuk përbën plagjiaturë, por lidhet me perifrashim të pasaktë, citim jo të plotë ose gabime metodologjike me pakujdesi;
 - c) **mbi 30% deri në 50%** – **plagjiaturë**, kur konstatohet përdorim i konsiderueshëm i përmbajtjes së huaj pa atribuum të duhur, që cenon pjesërisht integritetin e punimit;
 - ç) **mbi 50%** – **plagjiaturë e rëndë ose shumë e rëndë**, kur konstatohet plagjiaturë e gjerë, e përsëritur ose e qëllimshme, përfshirë dorëzimin ose publikimin e punës së tjetrit si punë personale ose përfitim të padrejtë akademik apo financiar.

Neni 12

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e informacionit



1. Universiteti i Tiranës garanton konfidencialitetin e plotë të të dhënave, dokumenteve dhe informacionit që lidhen me proceset e parandalimit, verifikimit dhe trajtimit të rasteve të dyshuara për plagjiaturë ose shkelje të etikës akademike.
2. Të gjitha subjektet që marrin pjesë në këto procese, përfshirë personelin akademik, administrativ, anëtarët e komisioneve, Këshillin e Etikës dhe ekspertët e angazhuar, janë të detyruar të respektojnë parimin e konfidencialitetit dhe të përdorin informacionin vetëm për qëllimet për të cilat është mbledhur.
3. Informacioni që lidhet me raportet e sistemeve antiplagjiaturë, dokumentacionin shoqërues, komunikimet procedurale dhe vendimmarrjet institucionale nuk bëhet publik dhe nuk u komunikohet palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji ose aktet nënligjore në fuqi.
4. Përpunimi, ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale dhe akademike bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me rregullat e brendshme të Universitetit të Tiranës.
5. Shkelja e detyrimit të konfidencialitetit përbën shkelje disiplinore dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi për Arsimin e Lartë dhe akteve të brendshme të Universitetit të Tiranës.

KREU III

PROCEDURAT E VERIFIKIMIT DHE TRAJTIMIT TË RASTEVE TË DYSHUARA PËR PLAGJIATURË

Neni 13

Legjitimimi për inicimin e procedurës dhe dokumentacioni provues

1. Procedura për verifikimin e një rasti të dyshuar për plagjiaturë iniciohet me kërkesë drejtuar drejtuesit të njësisë bazë ose Rektorit të Universitetit të Tiranës.
2. Të drejtën për të inicuar procedurën kanë subjektet që provojnë një interes akademik ose institucional të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm sa më poshtë:
 - a) autorin/bashkautorin e veprës që pretendohet se është cenuar;
 - b) strukturat akademike të UT-së, kur dyshimi konstatohet gjatë vlerësimit, mbrojtjes, publikimit ose promovimit akademik;
 - c) anëtarët e bordeve editoriale ose shkencore të revistave shkencore apo konferencave, në kuadër të proceseve të vlerësimit ose publikimit shkencor.
3. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe të përmbajë, sa më konkretisht të jetë e mundur:



- a) identifikimin e punimit objekt shqyrtimi;
- b) pjesët e pretenduara si të plagjiuara;
- c) burimet origjinale të mundshme;
- ç) çdo dokumentacion ose provë paraprake mbështetëse.

4. Universiteti i Tiranës mund të iniciojë procedurën ex officio vetëm kur dyshimi për plagjiaturë lind nga verifikime të brendshme, si rezultat i proceseve formale të vlerësimit akademik në kuadër të proceseve të promovimit akademik të personelit akademik. Në këtë rast, dyshimi i arsyetuar për plagjiaturë konstatohet dhe dokumentohet nga komisionet e promovimit të personelit akademik, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore dhe shërben si indicie për fillimin nga ana e Rektorit të UT të procesit të verifikimit të plagjiaturës së dyshuar.

Neni 14

Procedura paraprake për shqyrtimin e kërkesave mbi plagjiaturën e dyshuar

1. Kërkesa e arsyetuar për verifikimin e plagjiaturës së dyshuar shqyrtohet fillimisht nga drejtuesi i njësisë bazë. Në rast se kërkesa i është drejtuar Rektorit të Universitetit të Tiranës, ky i fundit ia përcjell Njesisë bazë për shqyrtim.
2. Drejtuesi i njësisë bazë brenda dhjetë (10) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, vlerëson nëse kërkesa plotëson kushtin e legjitimitetit dhe vendos:
 - a) fillimin e procedurës së verifikimit; ose
 - b) mosfillimin e procedurës, me vendim të arsyetuar me shkrim.
3. Kundër vendimit të drejtuesit të njësisë bazë për mosfillimin e procedurës së verifikimit, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Dekanatit/Rektorit të Universitetit të Tiranës brenda pesë (5) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kur kërkesa i është drejtuar Rektorit të Universitetit të Tiranës, Rektori, brenda dhjetë (10) ditëve nga data e dorëzimit, vlerëson nëse kërkesa plotëson kushtin e legjitimitetit dhe, në rast miratimi, ia përcjell njësisë bazë përkatëse për fillimin e procedurave të verifikimit.
5. Në rast se kërkesa ose njoftimi vlerësohet paraprakisht si minimalisht i bazuar, drejtuesi i njësisë bazë, brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e vendimit për fillimin e procedurës, ngre një Komision ad-hoc.
6. Komisioni ad-hoc përbëhet nga të paktën tre (3) anëtarë të personelit akademik të kategorisë “Profesor”.
7. Anëtarët e Komisionit ad-hoc nuk duhet të jenë në konflikt interesi me çështjen objekt shqyrtimi dhe janë të detyruar ta deklarojnë këtë fakt përpara fillimit të procedurës.
8. Komisioni ad-hoc, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e ngritjes së tij:
 - a) shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues;



- b) administron dhe shqyrton raportin e gjeneruar nga sistemet antiplagjiaturë, si dhe çdo informacion tjetër që e vlerëson të nevojshëm;
 - c) krahason përmbajtjen e punimit me burimet përkatëse dhe vlerëson natyrën dhe shkallën e ngjashmërive të konstatuara;
 - ç) administron shpjegime, deklaramë dhe prova nga palët e përfshira gjatë gjithë procesit të shqyrtimit.
9. Pas përfundimit të shqyrtimit, Komisioni ad-hoc përgatit një raport të arsyetuar, i cili përmban:
- a) përshkrimin e fakteve dhe provave të administruara;
 - b) analizën akademike dhe etike të ngjashmërive të konstatuara;
 - c) vlerësimin për ekzistencën ose jo të plagjiaturës dhe nivelin e saj;
 - ç) rekomandimet përkatëse, përfshirë masat e propozuara.
10. Raporti i arsyetuar i Komisionit ad-hoc i përcillet drejtuesit të njësisë bazë për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 15

Shqyrtimi dhe vendimmarrja në nivel njësie bazë

1. Pas dorëzimit të raportit të Komisionit ad-hoc, drejtuesi i njësisë bazë e vendos raportin dhe dokumentacionin shoqërues për shqyrtim nga njësia bazë.
2. Njësia bazë, brenda një afati prej njëzet (20) ditësh nga data e dorëzimit të raportit dhe dokumentacionit përkatës, merr vendim të arsyetuar për:
 - a) miratimin e raportit të Komisionit ad-hoc ose ndryshimin e tij ose
 - b) mosmiratimin e raportit, me arsyetim përkatës që hartohet nga drejtuesi i njësisë bazë.
3. Në rast se nga shqyrtimi i raportit rezulton se nuk ekzistojnë elemente të plagjiaturës, procedura përfundon në këtë fazë dhe palët njoftohen me shkrim për vendimin.
4. Kundër vendimit të njësisë bazë mund të bëhet ankim pranë Rectorit të Universitetit të Tiranës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Rectori shqyrton ankimin brenda 10 (dhjetë) ditëve dhe vendos sipas rastit:
 - a) lënien në fuqi dhe miratimin e vendimit të departamentit ose
 - b) kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm tek Këshilli i Etikës.
5. Në rast se njësia bazë vlerëson se ekzistojnë elemente të plagjiaturës, dosja e plotë i përcillet, nëpërmjet Rectorit, Këshillit të Etikës për shqyrtim dhe vendimmarrje, sipas kompetencave të tij.

Neni 16

Shqyrtimi nga Këshilli i Etikës dhe vendimmarrja përfundimtare

1. Pas përcjelljes së raportit të Komisionit ad-hoc, vendimit të arsyetuar të njësisë bazë dhe dokumentacionit provues përkatës, Këshilli i Etikës shqyrton çështjen në tërësi, administron dokumentacionin, dëgjon palët dhe e vlerëson propozimin në përputhje me parimet e etikës



akademike, integritetit shkencor, standardeve institucionale të Universitetit të Tiranës dhe kuadrit rregullator në fuqi për kërkimin shkencor.

2. Këshilli i Etikës përgatit raportin përfundimtar të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e marrjes së dokumentacionit të plotë.

3. Raporti përfundimtar i Këshillit të Etikës, së bashku me dokumentacionin mbi të cilin është mbështetur dhe rekomandimet përkatëse, i përcillet Rektorit të Universitetit të Tiranës për vendimmarrje përfundimtare, sipas kompetencave të përcaktuara në Statutin dhe aktet e brendshme të Universitetit të Tiranës.

4. Rektori, pas shqyrtimit të raportit dhe rekomandimeve të Këshillit të Etikës, brenda një afati prej njëzet (20) ditësh, merr një nga vendimet e mëposhtme:

a) miratimin e rekomandimeve dhe fillimin e procedurave të mëtejshme për marrjen e masave disiplinore ose administrative, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje, pranë strukturave kompetente, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) kthimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm pranë Këshillit të Etikës, kur konstatohet nevoja për plotësim të procedurës ose sqarim të fakteve;

c) mosfillimin e procedurave disiplinore, kur vlerëson se nuk ekzistojnë elemente të shkeljes.

5. Vendimi i arsyetuar i Rektorit, u komunikohet palëve të interesuara me shkrim dhe zbatohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Në rast se Rektori vendos kthimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm, Këshilli i Etikës është i detyruar të rishqyrtojë çështjen dhe të paraqesë raportin e plotësuar brenda një afati prej njëzet (20) ditësh nga data e kthimit të dosjes. Në rast të vendimmarrjes nga Këshilli i Etikës, ndiqet e njëjta procedurë e parashikuar në këtë rregullore për fazat e mëtejshme.

Neni 17

Të drejtat procedurale të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura e ankimit

1. Personi, ndaj të cilit zhvillohet procedura, gëzon të drejtën për proces të rregullt dhe, në veçanti, ka të drejtë:

a) të informohet me shkrim për pretendimet dhe gjetjet konkrete;

b) të njihet me materialet dhe provat mbi të cilat mbështetet hetimi administrativ;

c) të paraqesë shpjegime, kundërshtime dhe prova mbrojtëse brenda afateve të përcaktuara;

ç) të kërkojë përjashtimin e anëtarëve të komisionit për arsye konflikti interesi;

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk cenon konfidencialitetin, integritetin dhe efikasitetin e procedurës.

KREU IV



PROCEDURA E VERIFIKIMIT DHE TRAJTIMIT TË RASTEVE TË DYSHUARA PËR
PLAGJIATURË PËR STUDENTËT

Neni 18

Parimet e përgjithshme të procedurës për studentët

1. Procedura e verifikimit dhe trajtimit të rasteve të dyshuara për plagjiaturë për studentët zhvillohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, transparencës, edukimit akademik, konfidencialitetit dhe të drejtës për proces të rregullt.
2. Procedura ka për qëllim parësor edukimin dhe korigjimin akademik të studentit, veçanërisht për shkeljet e lehta dhe të paqëllimshme, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e integritetit akademik dhe reputacionit institucional të Universitetit të Tiranës.
3. Zbatimi i procedurës merr parasysh ciklin e studimit, nivelin e përvojës akademike të studentit dhe natyrën e punimit objekt shqyrtimi.

Neni 19

Inicimi i procedurës

1. Procedura për studentët iniciohet kur lind dyshimi për plagjiaturë gjatë vlerësimit të një punimi akademik, projekti, detyre kursi, punimi përfundimtar ose disertacioni.
2. Inicimi i procedurës bëhet:
 - a) nga pedagogu i lëndës, drejtuesi i punimit ose komisioni i vlerësimit;
 - b) nga drejtuesi i njësisë bazë ose drejtuesi i njësisë kryesore;
3. Dyshimi dokumentohet me raportin përkatës të sistemit antiplagjiaturë dhe me identifikimin e pjesëve të kontestuara të punimit.

Neni 20

Shqyrtimi paraprak akademik

1. Në rastet kur dyshimi lidhet me shkelje të lehta ose gabime metodologjike pa qëllim mashtrues, kryhet një shqyrtim paraprak nga pedagogu i lëndës ose drejtuesi i punimit.
2. Pas shqyrtimit paraprak:
 - a) procedura përfundon, nëse nuk konstatohet plagjiaturë;
 - b) aplikohen masa edukative, nëse konstatohet shkelje e lehtë;
 - c) çështja i referohet njësisë bazë, nëse ekzistojnë elemente që kërkojnë shqyrtim institucional.
3. Studenti njoftohet me shkrim për gjetjet paraprake dhe ka të drejtë të japë shpjegime.

Neni 21

Shqyrtimi në nivel të Njësisë Bazë



1. Kur çështja referohet në njësinë bazë, drejtuesi i njësisë bazë, pasi vlerëson se dyshimi është minimalisht i bazuar, ngre një komision ad-hoc, në përputhje me këtë rregullore.
2. Komisioni ad-hoc:
 - a) administron raportin e sistemit antiplagjiaturë;
 - b) analizon përmbajtjen e punimit;
 - c) krahason burimet përkatëse;
 - ç) administron shpjegime dhe prova nga studenti.
3. Komisioni përgatit raport të arsyetuar dhe ia paraqet njësisë bazë për shqyrtim.
4. Njësia bazë, pas shqyrtimit të raportit të komisionit ad-hoc, merr vendim të arsyetuar për një nga alternativat e mëposhtme:
 - a) mbylljen e procedurës, kur nuk konstatohet plagjiaturë;
 - b) aplikimin e masave për shkelje të lehta;
 - c) përcjelljen e çështjes në Këshillin e Etikës për shqyrtim të mëtejshëm.
5. Vendimi i njësisë bazë i komunikohet studentit me shkrim.

Neni 22

Shqyrtimi nga Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës shqyrton rastet e shkeljeve mesatare, të rënda ose të përsëritura, mbi bazën e dokumentacionit të përcjellë.
2. Studenti ka të drejtë të njihet me materialet, të paraqesë shpjegime me shkrim dhe, sipas rastit, të dëgjohej.
3. Këshilli i Etikës harton raportin përfundimtar të arsyetuar dhe propozon masat disiplinore përkatëse.

Neni 23

Vendimmarrja përfundimtare

1. Raporti i Këshillit të Etikës i përcillet Rektorit për miratim përfundimtar.
2. Vendimi përfundimtar:
 - a) përcakton masën disiplinore;
 - b) përcakton afatet dhe kushtet e zbatimit;
 - c) i komunikohet studentit me shkrim.

Neni 24

E drejta e ankimit



1. Studenti ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të Universitetit të Tiranës.
2. Ankimi nuk pezullon automatikisht zbatimin e masës, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga organi kompetent.

Neni 25

Mbyllja e procedurës dhe regjistrimi institucional

1. Çdo procedurë përfundon me një vendim të arsyetuar dhe regjistrohet në regjistrin institucional të rasteve të shkeljes së etikës akademike, në përputhje me rregullat e konfidencialitetit.
2. Të dhënat përdoren vetëm për qëllime institucionale dhe statistikore.

KREU V

SANKSIONET

Neni 26

Parimet e sanksionimit

1. Vendosija e sanksioneve bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe merr parasysh në veçanti:
 - a) shkallën dhe natyrën e shkeljes;
 - b) nivelin e qëllimshmërisë ose pakujdesisë;
 - c) përvojën akademike të subjektit;
 - ç) përsëritjen e shkeljes;
 - d) ndikimin e shkeljes në integritetin akademik dhe reputacionin institucional.
2. Në rastet e shkeljeve të rënda ose shumë të rënda, mund të aplikohen masa disiplinore më të ashpra, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit të Tiranës.

Neni 27

Sanksionet për kategorinë e studentëve

1. Në rast konstatimi të një shkeljeje të lehtë (vepër e parë), e cila përfshin perifrazim të pasaktë, citim të paplotë ose gabime metodologjike me pakujdesi, ndaj studentit aplikohen masat e mëposhtme:
 - a) detyrimi për rishkrimin, korrigjimin ose përsëritjen e punimit përkatës, brenda afatit të përcaktuar nga struktura akademike kompetente;



b) detyrimi për të ndjekur udhëzim metodologjik dhe këshillim akademik lidhur me rregullat e citimit dhe standardet e integritetit akademik.

2. Në rast konstatimi të një shkeljeje mesatare ose të një shkeljeje të lehtë të përsëritur, ndaj studentit aplikohen një ose më shumë nga masat e mëposhtme, në varësi të rrethanave konkrete të rastit:

a) moskalimi i lëndës, modulit ose punimit përkatës;

b) pezullimi nga studimet për një (1) semestër akademik.

3. Në rast konstatimi të një shkeljeje të rëndë ose shumë të rëndë, përfshirë plagjiaturë të gjerë, të qëllimshme, blerje ose dorëzim të punimeve akademike si punë personale, ndaj studentit aplikohen masat e mëposhtme:

a) përjashtimi nga Universiteti i Tiranës;

b) ndalimi i regjistrimit në Universitetin e Tiranës për një periudhë jo më pak se dy (2) vite akademike.

4. Në rast konstatimi të plagjiaturës së rëndë ose shumë të rëndë në kuadër të studimeve të ciklit të tretë (Doktoraturë/Master Ekzekutiv), përfshirë plagjiaturë të gjerë, të qëllimshme, blerje, porositje ose dorëzim të punimeve akademike si punë personale, ndaj studentit doktorant aplikohen masat e mëposhtme:

a) ndërprerja e menjëhershme e studimeve doktorale;

b) shpallja e pavlefshmërisë së disertacionit, si dhe e çdo rezultati, publikimi ose përfitimi akademik të lidhur drejtpërdrejt me të;

c) ndalimi i regjistrimit në programe doktorale në Universitetin e Tiranës për një periudhë jo më pak se dy (2) vite akademike.

5. Zbatimi i këtyre masave bëhet në përputhje me procedurat disiplinore në fuqi dhe pa cenuar të drejtën e ankimit sipas legjislacionit përkatës.

Neni 28

Sanksionet për personelin akademik dhe kërkimor-shkencor sipas nivelit të plagjiaturës

1. Në rast të konstatimit të nivelit 0–15%, ndaj personelit akademik dhe kërkimor-shkencor nuk aplikohet asnjë masë disiplinore, dhe procedura mbyllet pa pasoja, pasi nuk konstatohet shkelje e etikës akademike.

2. Në rast të konstatimit të shkeljes së lehtë të etikës në kërkimin shkencor (mbi 15% deri në 30%), ndaj personelit akademik dhe kërkimor-shkencor aplikohen një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

a) vërejtje me shkrim;

b) detyrimi për korrigjimin ose rishikimin e materialit që përmban elementë të plagjiaturës;

c) detyrimi për ndjekjen e trajnimit të detyrueshëm mbi integritetin akademik dhe etikën në kërkim.



3. Në rast të konstatimit të plagjiaturës në nivel shkeljeje mesatare (mbi 30% deri në 50%), ndaj personelit akademik dhe kërkimor-shkencor aplikohen, në mënyrë kumulative ose alternative, masat e mëposhtme:

- a) Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna;
- b) Detyrimi për korigjimin ose tërheqjen e publikimit nga revista, konferenca ose platforma përkatëse;
- c) Ndalimi i aplikimit për projekte kërkimore, grante ose financime për një periudhë deri në 1 (një) vit;

ç) kufizimi i përkohshëm deri në 1(vit) i angazhimeve akademike, përfshirë drejtimin shkencor, pjesëmarrjen në komisione dhe funksione drejtuese;

d) detyrimi për kompensim akademik sipas parimit të proporcionalitetit, si më poshtë:

– kur konstatohet plagjiaturë në një (1) artikull shkencor/ referim në konferenca subjekti detyrohet të realizojë dhe publikojë jo më pak se dy (2) artikuj shkencorë origjinalë, brenda një periudhe të përcaktuar nga organet kompetente;

– kur konstatohet plagjiaturë në dy (2) artikuj shkencorë/ referime në konferenca, subjekti detyrohet të realizojë dhe publikojë jo më pak se katër (4) artikuj shkencorë origjinalë, brenda një periudhe të përcaktuar;

4. Në rast të konstatimit të plagjiaturës së rëndë dhe të përsëritur (mbi 50%), ndaj personelit akademik dhe kërkimor-shkencor mund të iniciohet procedura disiplinore për zgjidhjen e kontratës dhe largimin nga detyra të personelit akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Afatet, periudhat kohore dhe kushtet konkrete për zbatimin e masave disiplinore dhe detyrimeve korigjuese të parashikuara në këtë nen, përfshirë periudhën e ndalimit për aplikim në projekte si edhe afatin për realizimin e publikimeve kompensuese përcaktohen në vendimin përfundimtar të miratuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës, mbi bazën e rekomandimeve të Këshillit të Etikës dhe rregullave të parashikuara në kuadrin rregullator mbi arsimin e lartë dhe Statutit të UT.

Neni 29

Rastet e konstatimit të plagjiaturës në disertacione doktorale pas fitimit të titujve dhe kualifikimeve pasuese akademike

1. Në rast se konstatohet plagjiaturë në një disertacion doctoral, pasi subjekti ka përfituar tituj dhe kualifikime pasuese akademike, përfshirë titullin “Profesor i Asociuar” dhe/ose “Profesor”, dhe kur subjekti:

a) ka zhvilluar një veprimtari të qëndrueshme akademike dhe kërkimore-shkencore pas përfundimit të studimeve doktorale;

b) ka vijuar kualifikimin e mëtejshëm profesional dhe shkencor në përputhje me kriteret ligjore në fuqi;



c) ka përfitur tituj pasues akademikë mbi bazën e veprimtarisë së mëvonshme dhe të pavarur nga disertacioni doktorial;

ç) nuk ka përsëritur shkelje të integritetit akademik gjatë karrierës së tij;

vlerësimi i çështjes dhe masat përkatëse merren duke respektuar parimin e proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe interesin institucional.

2. Kur nga vlerësimi cilësor dhe gjithëpërfshirës rezulton se materiali i konstatuar si plagjiaturë në disertacionin doktorial:

a) nuk ka qenë përcaktues për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe

b) nuk ka cenuar thelbin e kontributit origjinal të disertacionit;

nuk aplikohet revokimi i gradës shkencore “Doktor” dhe as i titujve pasues akademikë.

3. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, ndaj personelit akademik aplikohen masa korigjuese dhe institucionale, të cilat mund të përfshijnë, individualisht ose në mënyrë kumulative, një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) konstatim formal i shkeljes së etikës akademike me vendim të arsyetuar të Këshillit të Etikës;

b) regjistrimi i rastit në regjistrin institucional të etikës akademike sipas nenit 30 të kësaj rregulloreje;

c) detyrimi për publikimin e një deklarate korigjuese ose shënimi etik shpjegues në arkivën institucionale të disertacionit;

ç) korigjimi ose plotësimi i pjesëve përkatëse të disertacionit, i shoqëruar me shënimin përkatës që garanton transparencën akademike;

d) kufizimi i përkohshëm deri në 1 (një) vit i ushtrimit të roleve drejtuese akademike ose i drejtimit të studimeve doktorale;

dh) ndalimi i përkohshëm deri në 1 (një) vit për aplikim në projekte kërkimore të financuara, kur kjo vlerësohet e nevojshme për ruajtjen e besueshmërisë institucionale.

4. Revokimi i gradës shkencore ‘Doktor’ dhe i titujve pasues akademikë përbën masë të jashtëzakonshme (ultima ratio) dhe zbatohet vetëm në rast se konstatohet, në mënyrë kumulative, se:

a) ekziston plagjiaturë e rëndë ose shumë e rëndë, sistematike dhe e qëllimshme;

b) plagjiatura ka qenë element thelbësor dhe përcaktues për dhënien e gradës shkencore ‘Doktor’, në atë masë sa, pa përmbajtjen e plagjuar, grada nuk do të ishte dhënë në momentin e mbrojtjes;

c) ekziston lidhje shkakësore e provueshme ndërmjet plagjiaturës dhe përfitimeve akademike ose profesionale të mëvonshme, të realizuara në mungesë të integritetit akademik;

ç) masat korigjuese ose disiplinore më të lehta rezultojnë të pamjaftueshme për rivendosjen e integritetit akademik dhe besueshmërisë institucionale



5. Afatet, periudhat dhe kushtet konkrete për zbatimin e masave korigjuese të parashikuara në këtë nen përcaktohen në vendimin përfundimtar të miratuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës, mbi bazën e rekomandimeve të Këshillit të Etikës.
6. Revokimi i gradës shkencore “Doktor” bëhet me vendim të Rektorit të UT, bazuar në rekomandimin e Këshillit të Etikës.

Neni 30

Pasojat administrative dhe institucionale

1. Çdo rast i verifikuar i plagjiaturës regjistrohet në një regjistër të brendshëm institucional, i administruar pranë Këshillit të Etikës, në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Kur puna e konstatuar si plagjiaturë është publikuar, Universiteti i Tiranës:
 - a) njofton revistën, botuesin ose institucionin përkatës për tërheqjen ose korigjimin e publikimit;
 - b) publikon, kur është e nevojshme, një njoftim korigjues institucional.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 31

Dispozita kalimtare

1. Procedurat për verifikimin dhe trajtimin e rasteve të dyshuara për plagjiaturë, të cilat kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, përfundojnë sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, për sa kohë që kjo nuk cenon parimin e mosretroaktivitetit të masave disiplinore më të rënda.
2. Punimet akademike dhe shkencore të dorëzuara ose të publikuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje i nënshtrohen verifikimit sipas rregullave në fuqi në kohën e dorëzimit ose publikimit, përveç rasteve kur ato sjellin pasoja më të rënda ose kur konstatohet plagjiaturë e rëndë ose shumë e rëndë që cenon seriozisht integritetin akademik.

Neni 32

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës dhe publikimit në faqen zyrtare të Universitetit.



2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda 3 (tre) muajve shfuqizohen ose përshtaten të gjitha dispozitat e mëparshme të Universitetit të Tiranës dhe Njësive Kryesore në përputhje me parashikimet sipas kësaj rregulloreje.

3. Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për të gjitha njësitë akademike, studentët, personelin akademik dhe kërkimor-shkencor të Universitetit të Tiranës.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

